



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
		
Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo		
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV - ARCHIV - ARCHIVE		
Nr. Prot. Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. page	Data Date
516	4	20.01.2023
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA		

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE TË OIK në mbështetje të nenit 1 dhe nenit 3 të rregullorës për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, të zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 20/01/2023, nxjerr këtë:

**KOD I MIRËSJELLJES GJATË PROCESIT PËR ZGJEDHJEN E
ORGANEVE TË OIK**

Neni 1

Qëllimi i Kodit të sjelljes

1.1 Kodi i sjelljes ka për qëllim krijimin kushteve ku anëtarët e OIK mund të zgjedhin përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjetë lira, të drejta dhe të mir-informuara, në një atmosferë kolegjiale dhe respekti të rregullave të legjislacionit përkatës

Neni 2

Përgjegjësitë e kandidatëve dhe mbështetësve të tyre

2.1 Këtij Kodi i detyrohen të gjithë anëtarët e OIK, vecanarisht kandidatët për anëtarë të organeve të OIK

2.2 Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) ka autoritet ligjor të marë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtij Kodi si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me proedurat e saj.

2.3 Kandidatët për anëtarë të organeve të OIK-ut ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja këtij Kodi.

2.4 Kandidatët për anëtarë të organeve si edhe vetë anëtari i OIK mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga mbështetësit e tyre.

2.5 Kandidatët për anëtarë të OIK mund të paraqesë prova pranë KQZ-së që tregojnë se ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar dhe/ose dekurajuar anëtarët dhe mbështetësit e tyre nga shkelja e Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e dukur të masave të

mëtejshme dhe mund të përfshijë dëshmi se:

- (a) Kandidati për anëtarë të organeve të OIK i ka informuar mbështetësit e tij për dispozitat e këtij Kodi dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij;
- (b) Kandidati për anëtarë të organeve të OIK publikisht është shprehur për dënimin e dhunës, kërcënimeve me dhunë, apo frikësim gjatë procesit zgjedhor;
- (c) Kandidati për anëtarë të organeve të OIK nuk ka nxitur, shtytur apo përkrahur mbështetësit e tij në shkeljen e Rregullave të zgjedhjeve në ndonjë rast të veçantë apo në raste tjera; dhe
- (d) çdo provë tjetër në lidhje me përpjekjet e kandidatit për anëtarë të organeve të OIK për të parandaluar mbështetësit nga shkelja e Rregullave të zgjedhjeve.

Neni 3

Veprimet e ndaluara

3.1 Gjatë periudhës së fushatës anëtarëve të OIK, kandidatëve për organet e OIK i'u ndalohen nveprimet si në vijim:

- (a) Keqinofrimimi, shpifja dhe njellosja e procesit zgjedhorë apo kundërkandidatëve në proces zgjedhor
- (b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, n
- (c) pengimi ose tentimi për pengimin e zyrtarëve të KQZ-së për përmbushjen e detyrave zgjedhore
- (d)premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;
- (e) kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar anëtarët - kandidatët tjerë për organe të OIK apo mbështetësit e tyre
- (f) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;
- (g) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër;
- (h) abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dheirituese në prganet përgjegjëse për mbarvajtjen e zgjedhjeve ;
- (i) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke

publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikimtë tillë; ose

- (j) për qëllime të promovimit të kandidaturës së tij për anëtarë të organeve të OIK duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili mban detyrë zyrtare brenda institucionit apo në çfarëdo forme mund të jetë person me ndikim të anëtarët, ndikim i cili vë në pozita të tij në institucion:

Neni 4

Veprimet e ndaluara nga shërbyesit publik

5.1 Anëtari i OIK ose kandidati për anëtarë të organeve të OIK që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë kandidati për anëtarë të organeve të OIK në zgjedhje.

5.2 Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë anëtarë i OIK apo kandidatë për anëtarë të organeve të OIK, nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për kandidatin e caktuar për anëtarë të organeve të OIK.

Neni 5

Veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore

6.1. Gjatë periudhës njëzet e katër orëshe (24) para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, anëtarët e OIK, kandidatët për anëtarë të organeve të OIK dhe mbështetësit e tyre u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë :

- (e) ndikimi, shpërndarja ose shfaqja në mënyre tjetër në qendrën e votimit, ose 100 metra brenda Qendrës së Votimit e çfarëdo lloj materiali me qëllim të ndikimit të votuesve; ose të sigurojë mbështetjen nga personat që presin për të votuar në vendvotime ose qendra votimi
- (f) Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre

Neni 6

Pranimi i rezultateve të zgjedhjeve

7.1. Të gjithë kandidatët për anëtarë të organeve të OIK dhe mbështetësit e tyre, obligohet t'u përmbahen rezultateve të zgjedhjeve si dhe të mbështesin zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuar.

Neni 7

Sanksionet për shkeljen e parimeve të këtij Kodi

8.1. Shkeljet e ndonjërit nga nenet e këtij kodi, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultat të zgjedhjeve, konsiderohet si shkelje e lehtë dhe është e sanksionuar me njërin nga masat e mëposhtme :

- (a) Vërejtje
- (b) qortim publik

(g) 8.2. Shkeljet e ndonjërit nga nenet e këtij kodi, në rastet kur këto shkelje kanë ndikuar në rezultat të zgjedhjeve, konsiderohet si shkelje e lehtë dhe është e sanksionuar me njërin nga masat e mëposhtme:

- (a) Denimi me gjobë 1000 - 3000 euro
- (b) Tërheqje e përkohëshme apo e përhershme nga regjistri i anëtarësisë dhe licencave

8.2.1. Shqiptimi i masave disiplinore nuk e konsumon veprën penale që realizohet me shkeljen e dispozitave zgjedhore të përcaktuara nga OIK.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Kod zgjedhorë hyn në fuqi menjëherë.

Prishtinë me 20/01/2023



Kryetari i KQZ-së së OIK

Hysni Bajrami